



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti

Mbledhja nr. 139/2024

Prishtinë, më 5.7.2024, në orën 12:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja, Driton Hyseni, Gramos Agusholli, Abelard Tahiri, Valentina Bunjaku - Rexhepi dhe Pal Lekaj anëtarë.

I ftuar: Jeton Mehmeti, kryesues i Bordit të Ndërmarrjes Publike të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh.a.

Pjesëmarrës tjerë: Ajrina Gashi – Hamdiu, Nebih Zariqi, Arben Dodaj, Evetar Zeqiri, Shaban Neziri, Nebih Haziri – KOSTT; Doruntina Murturi – Kuvend, Lekë Batalli – ESA, Bedri Baliu, Salih Hoxha – GP LVV, Edina Avdiu – RTK, Fjollë Haziri – KDI, Valbona Bytyçi – KTV, Jeta Huruglica - GP LDK, dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Ndërmarrjes Publike të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh. A. për vitin 2023;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Ndërmarrjes Publike të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh.a. për vitin 2023;

Kryetari, tha se në bazë të nenit 29 të Rregullores së Kuvendit, dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 5 i Ligjit për energji elektrike, sot e shqyrtojmë raportin vjetor për vitin 2023, të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit Transmisionit dhe Tregut – KOSTT. Nga stafi e keni pranuar edhe një MEMO. Si procedurë ia kaloj fjalën z.Jeton Mehmeti, kryesues i Bordit të KOSTT-it, për të arsyetuar në pika të shkurta raportin dhe mandej hapim debat.

Jeton Mehmeti, kryesues i Bordit në KOSTT, tha se duke pasur parasysh se është raportimi i fundit për këtë mandat me lejoni të paraqes para jush të përmbledhura sfidat dhe sukseset të prezantojë përkushtimin tim dhe të anëtareve të Bordit të Drejtoresve gjatë këtij mandati 4 vjeçar. U ndjeva thellësisht i lënduar nga fakti se në Komision ku kam raportuar, hapur publikisht para mediave rreth 20 herë, është theksuar duan t'i shpëtojnë apo ikin përgjegjësisë së raportimit, asnjëherë nuk ka pasur dhe nuk do të ketë tendencë të tillë nga ana jonë, i shtojmë faktin se komisionet e tilla kanë kompetencë të të thërrasin edhe pas pesë apo dhjetë vitesh dhe gjithmonë do të jem i gatshëm të përgjigjem për përgjegjësitë e mia dhe të Bordit të Drejtoresve. Në karrierën time kam pasur nderin me të madh, kënaqësinë me i shërbye vendit dhe kam marrë përgjegjësinë me vetëbesim të plote me rastin e zgjedhjes nga deputetët e popullit në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pra, jemi të vetmit bord i drejtoresve në një ndërmarrje publike që japim llogari publikisht para institucionit më të lartë në hierarkinë e Republikës, asnjë ndërmarrje tjetër nuk raporton publikisht para kamerave, ne jemi të vetmit dhe suksesshëm kam raportuar me dhjetëra herë në komisione funksionale dhe hetimore për sfidat dhe sukseset.

Pra, unë si drejtues së bashku me anëtarët e tjerë të BD-së jemi përballur njëkohësisht me tre probleme/kriza të thella, si problemin e brendshëm institucional në KOSTT, të shkaktuar nga drejtoret e Bordit të mëparshëm që kanë shkaktuar betejën e ashpër ligjore ne mes te dy ish-kryeshefave ekzekutivë dhe kriza e pagesave të energjisë në veri dhe krizën energjetike, këto dy të fundit probleme jashtëzakonisht të mëdha për ndërmarrjen.

Në këtë kontekst, pa modesti e themi që KOSTT-i ka arritur të mirëmbajë komunikimin dhe partneritetin e duhur me mekanizmat ndërkombëtarë që madje edhe në rrethana të tilla të arrijë të vazhdoj Marrëveshjen e Kyçjes për periudhën vijuese dyvjeçare.

Që nga fillimi i krizës energjetike dhe luftës në Ukrainë, Sektori i energjisë është ballafaquar me probleme të paprecedentë. Funksionimi i bllokut rregullues Kosovë – Shqipëri menjëherë është vënë në sfidë për të ndihmuar njeri- tjetrin, me këtë rast pas daljes nga blloku SMM Serbi, Mali i Zi dhe Maqedoni, Bashkimi me Shqipërinë ka prodhuar një rezultat të menjëhershëm pasi që është arritur të menaxhohet kriza më mirë. Funksionimi si bllok rregullues, respektivisht sigurimi i shërbimeve ndihmese të balancimit për rezervën automatike nga OST e Shqipërisë kanë kontribuar dukshëm në menaxhimin më të lehtë të krizës. Një kontribut të madh në llogarinë balancuese kanë dhënë edhe ndërmarrjet publike vendore, duke ndihmuar sistemin dhe minimizuar devijimet nda interkoneksionit ndërkombëtar. Megjithatë, tani që po flasim ky problem me nuk ekziston pasi që si rezultat i përkushtimit maksimal të KOSTT-it është arritur që të bëhet operacionalizimi i furnizuesit të ri në veri, gjithë që i ka lejuar KOSTT-it të largojë barrën për përgjegjësinë e balancimit në pjesën veriore. Pra, menjëherë pas heqjes se këtij obligimi vërehen rezultatet pozitive në 6 mujorin e parë të vitit 2024. Por, me vetëbesim të palëkundur në vete për zbatim të ligjit dhe vendimmarrje të drejtë arrita të hedh në Bord përpara kolegëve të mi çdo propozim të ligjshëm dhe të nevojshëm dhe me e refuzua çdo kërkesë të parregullt dhe me u

siguria për të marrë vendime të drejta dhe të ligjshme, së bashku me ta. Ku nga 138 vendime të mara nga BD 90% e vendimeve janë me votë unanime. Krahas gjithë këtyre sfidave ka edhe suksese të jashtëzakonshme, kemi storie suksesi që i kalojnë kufijtë e shtetit.

Më pas prezantoi disa nga të arriturat kryesore brenda mandatit, si: hyrja në fuqi Marrëveshja e Kycjes KOSTT/ENTSO-E e cila ishte edhe çelësi i progresit shumëdimensional për KOSTT: Marrëveshja në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC) në vlerë prej 236.7 milionë Dollar; Nënshkrimi i tri Marrëveshjeve me Elektroserver, si palë kontraktuese, të cilat ndër të tjera parashohin edhe qasjen fizike në Nënstacionin 110/35kV në Vallaç, ashtu siç parashihet edhe në Udhërrëfyesin për zbatimin e Marrëveshjeve të Energjisë.; KOSTT (Kosova) tutje vazhdoi operimin e pavarur si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë, pjesë e zonës sinkrone të Evropës Kontinentale të ENTSO-E, ku pas përfundimit të afatit dyvjeçar, me 25 gusht 2022, u përmbyll me sukses votimi për vazhdimin e Marrëveshjes së Kycjes KOSTT/ENTSO-E nga Grupi Regjional i Evropës Kontinentale (RGCE), trup i ENTSO-E; Në aspektin e zhvillimit të tregut, iniciativa për krijimin e një tregu të përbashkët Kosovë-Shqipëri, në dhjetor të 2022, KOSTT dhe ALPEX (Dega në Kosovë) nënshkruan Marrëveshjen për Transfer të të drejtave për organizimin e tregut një ditë para dhe tregut ditë. Krijimi i Tregut të përbashkët Kosovë - Shqipëri është një hap tutje shumë i rëndësishëm drejt integritit në tregun gjithëevropian në harmoni me objektivat e Bashkimit Evropian dhe Komunitetit të Energjisë si dhe iniciativës WB6 (Western Balkan 6 Initiative); KOSTT dhe Komuna e Dragashit kanë nënshkruar kontratë për shfrytëzim të pronës për ndërtimin e Nënstacionit në Dragash; Nënshkrimi i kontratës me Komunën e Malishevës për shfrytëzim të pronës për ndërtimin e Nënstacionit në Malishevë; Kontratat e nënshkruara për projektet kryesore pa përfshire projektet e tjera: Ndërtimi i NS të ri GIS. 110/35/10(20) kV Fushë- Kosova; Ndërtimi i linjës/kabllos 110 kV për kycje të nënstationit të ri 110/35/10(20) kV Kastrioti LOT5; Ndërtimi i NS. 110/35/10(20) kV Ferizaj 3 (Kastrioti) me transformator 40MVA; Përgatitja e dokumentacionit ndërtimor projektues për NS 220/35/10(20) kV Malisheva; Në dhjetor të vitit 2022, është bërë nënshkrimi i marrëveshjes për kredi me KfW në vlerë prej 25.5 mil. Euro për financimin e projekteve të Fazës VII . Marrëveshja është Ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në nëntor 2023 dhe dekretuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës në dhjetor 2023; Projektet e fazës VII – të cilat do të financohen nga kredia me Bankën Gjermane për Zhvillim KfW të përfshijnë: LOT 1 - NS 110/10(20) kV- Dragashi me transformatorë 2x40MVA dhe linja transmetuese; LOT 2 - Rehabilitimi i NS dhe furnizimi me transformatorë të fuqisë 40MVA; LOT 3 - Dizajni, furnizimi dhe instalimi i transformatorëve të fuqisë: LOT 4 - linjat transmetuese:

Lidhur me Raportin Vjetor 2023, tha se paraqet rezultatet kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2023 si dhe të aktiviteteve krahasuar me Planin e Biznesit, planin vjetor dhe shkallën e realizimit, respektivisht, implementimin e Planit të Biznesit. Fillimisht më lejoni të potencoj faktin që viti 2023 ishte një nga vitet më të suksesshme për KOSTT, duke pasur parasysh që ndër të tjera, përfundimisht hoqëm barrën shumëvjeçare të furnizimit me energji elektrike të komunave veriore të Republikës së Kosovës, e cila do të na siguroj që bilancet tona financiare të jenë përsëri pozitive.

Nënshkruam Memorandumin e Mirëkuptimit për Bashkimin e Tregut të Ditës në Avancë të Energjisë Elektrike në EJK, ndërmjet Kosovës, Shqipërisë, Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut, si palë me rol kyç në tregun e energjisë elektrike në Evropën Juglindore, iniciativë kjo e cila

paraqet zgjerimin më të madh të sistemeve evropiane të energjisë elektrike me vendet jo anëtare të Bashkimit Evropian.

Pas një pritjeje të gjatë, Kuvendi i Republikës së Kosovës votoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë dhe projektit ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, KOSTT (Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh. a.) dhe KFW, Frankfurt AmMain (KFW), e cila hapi rrugën për nënshkrimin e Marrëveshjes për Nënhuazim për Projektin "Zhvillimi i sektorit të energjisë Faza VII – Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit", përmes së cilës do të bëhet financimi i një sërë projekteve të radhës për zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë.

Përmes bashkëpunimit të ngushtë ndër vite në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Fondit të Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), e cila në kuadër të programit Kompakt, synon instalimin e sistemit të ruajtjes së energjisë nëpërmjet baterive me kapacitet prej 170 MW (apo 340 MWh), me një vlerë totale prej 180 milion \$, KOSTT do të përfitojë kapacitetin 45 MW në vlerë prej 42.6 milionë \$. Në funksion të zgjerimit të ofrimit të shërbimeve, me mbështetjen e Bankës Botërore, aplikua në WBIF për grant për projektin "Balkans Digital Highway" që përfshin katër vende nga Ballkani Perëndimor. Faza e Parë përfshiu studime fizibiliteti të cilat përfunduan në dhjetor 2023 dhe me këtë siguroam pjesëmarrjen në fazën e dytë të projektit.

Bordi i Drejtorëve, si organ mbikëqyrës i KOSTT-it, gjatë vitit 2023 ka mbajtur 9 mbledhje të rregullta. Bordi i Drejtorëve ka shqyrtuar dhe miratuar të gjitha çështjet e parapara me planin e punës së Bordit të Drejtorëve, të cilat hyn në kuadër të obligimeve ligjore, si dhe në kuadër të përgjegjësisë që ka, ka miratuar politika, raporte dhe procedura përkatëse. Gjithashtu, edhe Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2023, ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje të rregullta, ku krahas shqyrtimit dhe miratimit të raporteve dhe dokumenteve përkatëse, ka adresuar rekomandime për miratim të materialeve respektive tek Bordi i Drejtorëve në kuadër të fushëveprimtarisë që ka. Bordi i Drejtorëve në ushtrimin e të drejtave dhe detyrave sipas Ligjit për Ndërmarrjeve Publike, në vazhdimësi ka shqyrtuar performancën e KOSTT-it dhe ka qenë mbështetës për menaxhmentin, në arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin e Biznesit, ku vendimet relevante përkatëse janë të prezantuara në kuadër të këtij raporti. Përpjekjet e KOSTT-it qysh nga themelimi, ishin dhe do të jenë edhe në të ardhmen, të orientuara drejt realizimit të objektivave të saj strategjike, të cilat janë në përputhje të plotë me rolin, misionin dhe vizionin e KOSTT-it. Duke u bazuar në të gjitha këto, edhe gjatë vitit 2023, përkundër vështirësive të mëdha që kanë ndodhur si rezultat i vazhdimit të krizës energjetike në vend dhe regjion, KOSTT-i ka vazhduar trendin e saj të performimit pozitiv, duke dëshmuar kështu se mbetet edhe më tutje një organizatë e qëndrueshme dhe efektive.

Gjatë vitit 2023 ka vazhduar me sukses operimi i KOSTT-it si zonë e pavarur rregulluese në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale si pjesë e bllokut Kosovë- Shqipëri respektivisht blloku AK.

Gjatë viti 2023 është realizuar 99% e planit vjetor të mirëmbajtjes së linjave, 95% e mirëmbajtjes së Qarqeve Primare, 98% i Qarqeve Sekondare dhe 89% i Mbrojtjeve Rele, si dhe janë zhvilluar aktivitetet e tjera të domosdoshme për sigurinë dhe stabilitetin e qëndrueshëm operativ dhe të sigurisë së sistemit elektroenergetik.

Gjatë tërë vitit 2023 ka vazhduar puna e grupeve punuese KOSTT-OST për të mundësuar implementimin e Marrëveshjes së Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK). Kjo marrëveshje obligon palët (KOSTT dhe OST) të punojnë bashkërisht në

operimin e bllokut të përbashkët sipas detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja SAFA dhe SOGL si dhe në harmoni me kodet nacionale të rrjetit.

Përkushtimi i KOSTT-it, për arritjen e objektivit të kompanisë siç është përgjegjësia në aspektin e sigurisë dhe mjedisit, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023. Viti është përmbyllur pa asnjë incident, lëndim të punëtorëve apo emergjencë mjedisore.

Në kuadër të procesit të implementimit të kornizës rregullative të sektorit të energjisë që ndërlidhet me procesin e Integritimeve Evropiane, KOSTT-i vazhdimisht ka qenë dhe është pjesë e procesit të raportimit mbi implementimin e masave ligjore dhe zbatuese të përfshira brenda Agjendës Evropiane për Integritim dhe Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim (PKZMSA), duke mos anashkaluar edhe Planin e Vjetor të Punës së Qeverisë së Kosovës (PVPQ) si pjesë ndërlidhëse me këtë proces integrues.

Opinionin e auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2022, është pa asnjë kualifikim, duke filluar qysh nga viti 2006. Kjo e arritur dëshmon më së miri punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimit të gjitha resurseve. Veç kësaj, KOSTT-i ka kryer me kohë obligimet ndaj klientëve dhe Institucioneve të shtetit të Kosovës, përveç detyrimeve të cilat rrjedhin nga llogaria e balancimit.

Sa i përket realizimit të projekteve kapitale, po ashtu, edhe projektet kryesore janë të paraqitura sipas kategorive, duke mundur një gjurmim të aktiviteteve dhe të dhënave të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2023. Të Planifikuara ishin 10,423,116 €, ndërsa të realizuara janë 4,915,919 €, të shprehura në përqindje, 47%.

Viti 2023 është ballafaquar me shumë pasiguri dhe rreziqet nga përmbartimet që ka ngjallur pasiguri nga aspekti financiar, gjë që ka shtyrë ndërmarrjen të ketë një qasje të kujdesshme ndaj investimeve kapitale. KOSTT-i ka arritur një nivel të lartë në ngritjen e cilësisë së kompanisë, parametrave teknik dhe financiar, si rezultat i kësaj KOSTT-i ka arritur të sigurojë financim të projekteve dhe donacione nga institucionet kredibile financiare ndërkombëtare si KFW, BERZH, Komisioni Evropian etj.

Numri i punëtorëve në datën 31 dhjetor 2022 në KOSTT ka qenë 339, ndërsa me datën 31 dhjetor 2023, numri i të punësuarve është 345. Gjatë vitit 2023 janë punësuar apo kanë filluar punën gjithsej 19 punëtorë të ri, të pranuar sipas zhvillimit të proceseve të rekrutimit përmes konkurseve të shpallura.

Gjatë periudhës kohore janar - dhjetor 2023, janë mbajtur gjithsej 133 seanca gjyqësore, prej 193 lëndëve gjyqësore që janë të evidentuara në raportet e tremujoreve për kontestet gjyqësore.

Sa i përket Kontratave/Transaksioneve gjatë vitit 2023 nga burimet e KOSTT-it, janë kontraktuar gjithsej 110 kontrata: 45 kontrata me procedurë të hapur; kontrata me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë; dhe 65 kontrata me vlera minimale.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, pyeti sa ka qenë buxheti i planifikuar në vitin 2023 dhe sa për qind është realizuar ky planifikim, sa ka qenë numri i projekteve për vitin 2023 dhe sa për qind e projekteve janë realizuar?

Evetar Zeqiri, kryeshf ekzekutiv në KOSTT, tha se buxheti i të hyrave nga tarifat ka qenë 92 milionë dhe është realizuar 91%, gjithsej buxheti për të hyrat tjera ka qenë 28.5 milionë euro dhe është realizuar 107%, buxheti i përgjithshëm nga të gjitha të hyrat ka qenë 120.5 milionë euro, ndërsa është realizuar 95%. Sa i përket projekteve, viti 2023, është diku 48% realizimi i projekteve dhe është % me e lartë e realizimit.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se në raport ceket që ndërmarrja është ballafaquar me rreziqe dhe është dashtë të ketë qasje të kujdesshme nga ndërmarrja, ajo pyeti se a është e vërtetë që ju keni kërkuar specifikacione për tenderë nga vartësit tuaj rreth projekteve para se të shpallen?

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se nuk është e vërtetë, janë procedurat në të cilat kalojnë projektet nëpër një cikël, i cili është i paraparë me ligj dhe rregulloret në fuqi.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se në vitin 2023, ndërmarrja kishte hartuar planin e prokurimit me 86 projekte, me vlerë totale prej 13.141.653 euro gjatë vitit ishin nënshkruar 111 kontrata në vlerë prej 1,193.733 euro, prej të cilave 67 ishin realizuar nëpërmjet procedurës së vlerës minimale që i bie 9% realizimi, cili është komenti i juaj?

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se nuk pajtohem me konstatimin tuaj, numri i procedurave të prokurimit dhe volumi i kontratave ndryshon, mund të ketë 90 procedura me vlerë 1,000.00 euro dhe e kundërta. Në vitin 2023 ka pasur procedura me vlerë minimale për këto arsye, kemi pas kontrata që kanë përfunduar në OSHP, siç është kontrata për mirëmbajtje dhe kositje të barit, në pamundësi për të kontaktuar disa herë në OSHP, jemi detyruar me vazhduar me nënstacionet të cilat janë ekspozuara nga rreziqet e zjarrit, sidomos në ato në zonat rurale ku ka më shumë bari. E dyta ka qenë furnizimi dhe mirëmbajtja e veturave, janë zhvilluar një seri procedurash të cilat kanë qenë në OSHP dhe ka qenë një rast specifik siç ka qenë furnizimi me material të zyrës të cilat kanë qenë po ashtu të atakuar në OSHP.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se kemi pranuar një e-mail nga znj. Zharku, e cila është larguar nga pozita e U.D. në Departamentin e Prokurimit dhe në vend të saj është caktuar një person tjetër i cili nuk ka licence të prokurimit, si ka ndodh?

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha nuk jam në dijeni për ankesa të tilla, ai tha se Ligji i Prokurimit Publik, përcakton kërkesat minimale që duhet të përmbush zyrtari përgjegjës i prokurimit, kur ka mungesë të stafit mund të kontraktohen zyrtarë nga institucione të tjera, Ligji i Prokurimit Publik përcakton se personi duhet të jetë i licencuar, duhet të jetë i diplomuar dhe duhet të ketë dorëzuar deklaratën në KRPP. Kërkoj që ky e-mail që iu është dërguar deputeteve, t'i dërgohet edhe atij personalisht.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se Ligji i Prokurimit Publik, neni 23, paragrafi 1 dhe 2, përcakton qartë, por ky person që e keni caktuar nuk e ka këtë certifikatë dhe keni ngarkuar znj. Zharku me dy përgjegjësi, edhe në pozitën paraprake edhe si zyrtarë përgjegjës e prokurimit, si pasojë ju keni paguar një person i cili nuk kryen asnjë funksion dhe kështu e keni dëmtuar buxhetin e shtetit.

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se zyrtari përgjegjës i prokurimit, jo patjetër duhet të jetë personi i fundit përgjegjës, për këtë e dhëne interpretimin edhe KRPP-ja, ky është vendim i menaxhmentit dhe gjendja faktike është ndryshe, pozita nuk lidhet me funksion.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, pyeti kryesuesin e bordit në lidhje me një udhëtim zyrtar jashtë vendit se bashku me një anëtare të bordit, cila ka qenë arsyeja e këtij udhëtimi dhe përfitimi nga ky udhëtim, kur kemi parasysh se me 10.7.2024 ju përfundon mandati, dhe sa ka kushtuar ky udhëtim.

Jeton Mehmeti, kryesues i bordit në KOSTT, tha se unë pretendoj edhe një mandat dhe ky udhëtim është realizuar për të marrë pjesë në një konferencë dy ditore, ligjërisht kemi të drejtë të marrim pjesë në konferencë për zhvillim profesional, në atë konferencë kam marrë pjesë me tendencë për përcjelljen e disa trendëve të reja të zhvillimit teknologjik që është teknologjia e baterive dhe integrimi i solarëve në rrjetin e sistemit. Nuk e di që ende sa ka kushtuar ky udhëtim sepse është realizuar para dy javëve dhe ka procedua të brendshme të shpenzimeve.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, pyeti kryeshefin, sa këshilltarë i keni, sa janë në proces të pranimit, a keni edhe shef të kabinetit?

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se aktualisht kemi dy këshilltarë në KOSTT, dhe kemi një këshilltar të specializuar me afat 12 mujor, për të zhvilluar politikat e implementimit të rrisqeve dhe e kemi edhe një këshilltar tjetër i specializuar me afat 12 mujor.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, pyeti rreth dhënies së një garancisë bankare nga ana e KOSTT, për një operator privat, na shpjegoni më shumë rreth kësaj garancie.

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se nuk kemi dhënë asnjë garanci bankare, është informatë e pasaktë.

Jeta Statovci, tha se kjo është jashtë temës sepse ky rast do të përfshihet në raportin për vitin 2024, sot jemi duke diskutuar për raportin e vitit 2023.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se edhe ne e dëgjuam kryesuesin kur doli nga tema duke raportuar për katër vjet mandat. Ajo pyeti kryeshefin e KOSTT në lidhje me hapjen e një konkursi për shef të kabinetit, ju për nga kabineti po dukeni sikur të jeni super ministri por në realitet nuk e dini sa asete keni dhe as vlerën e tyre sipas raportit të auditimit.

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se edhe me herët e ceka që kemi dy këshilltarë, kurse dy këshilltarë të specializuar janë të angazhuar me afat të caktuar, pra nuk kemi shumë por janë dy. Sa i përket aseteve, janë të shpalosura në raportin e auditorit të jashtëm, i cili i ka paraqit opinion të pamodifikuar të pasqyrat financiare, bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit, asete që janë me vlerë zero, në kontabilitet kur një aset zhvlerësohet në kuptimin e vlerës në kontabilitet, aseti ekziston, mirëpo, për qëllime kontabël e ka vlerën zero, sepse ne operojmë në një ambient tejet të rregulluar, ku të gjitha të hyrat aprovohen prej ZRRE-së. Rivlerësimi i aseteve bëhet për dy arsye kryesore, kur ndërmarrja dëshiron të shitet dhe kur është e listuar në bursë, në asnjërën nga këto dy rrethana ne nuk kemi planifikim dhe për këtë nuk kemi parë të arsyeshme të bëjmë rivlerësim të aseteve.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se në auditimin e pasqyrave financiare nga ZKA-ja, ju keni marrë auditor të jashtëm për auditim të KOSTT dhe keni paga në vlerë prej 44,250 euro, pse

është dashur angazhimi i një auditori të jashtëm kur ZKA-ja ju ka njoftuar me kohë se do të kryej auditimin.

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se nuk kemi paguar, ai tha se KOSTT është ndërmarrje/shoqëri aksionare dhe shoqëri ndërmarrje publike e cila ka obligim për të raportuar, bazuar në Ligjin për Raportim Financiar, afati për raportim të audituar të pasqyrave financiare është 31 mars respektivisht 31 prill, ZKA-ja pasqyrat e veta, në formën e saj i përfundon deri me 31 qershor si afat ligjor dhe rëndom nuk arrin mi publiku më herët për shkak të kapaciteteve të kufizuara, kjo është njëra arsye. Arsyeja e dytë është, se ne nuk mund të shkelim afatet e raportimit, ne kemi obligime ndaj ZRRE-së që të bëjmë raportime, ne kemi dy raporte të auditimi, auditime për qëllime të përgjithshme dhe auditime për qëllime të veçanta për ZRRE-në, mbi bazën e të cilave ZRRE-ja jep tarifën. Atë obligim ZKA-ja nuk e kryen, pra ne nuk mund të marrim tarifën nëse nuk dorëzojmë raport të auditorit të jashtëm dhe nëse ZKA-ja në vitin e ardhshëm e kryen këtë auditim dhe atë brenda afatit ligjor, ne nuk kemi arsye që të angazhojmë kompani të jashtme.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se bazuar në gjitha këto të gjetura qoftë nga raporti i auditimit apo edhe fakti që ju nuk e pranuat dhënien e garancisë bankare për një kompani private, bëjë thirrje publikisht që Prokuroria të merret me këtë rast dhe ta hetojë këtë rast dhe rastet tjera të publikuara në raportin e auditimit.

Mimoza Kusari – Lila, pasi falënderoi bordin për bashkëpunim në përgjatë këtij mandati, ajo tha se jo vetëm 3 anëtarëve, por edhe pjesës tjetër në një periudhë të afërt i përfundon mandati, keni kaluar në një periudhë të rëndë të krizës energjetike. Ajo pyeti të gjithë anëtarët e bordit, sa ju mendoni që konform hapave aktual me të cilët janë marrë vendime në KOSTT, në vitin 2023 dhe vijueshmërisë në vitin 2024, KOSTT-i sa është afër përmbushjes së objektivave të strategjisë të energjisë të cilën e kemi miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës për vitin 2022-2031, përfshirë këtu edhe kapacitetet me energji të ripertritshme dhe Ligjin për Burime të Ripertritshme. Ajo pyeti Kryeshefin, se a ka pasur ndonjëherë ndërhyrje apo kërkesa specifike për çështje të prokurimit publik, apo animit për kompani të caktuara nga anëtar të bordit, të cilëve deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës ia kemi dhënë besimin, qoftë nga ata, apo dikush nga politika. Ajo pyeti edhe në lidhje me projektin e parë me ankand publik me panele solare, që është projekt i vitit 2024.

Jeton Mehmeti, kryesues i Bordit në KOSTT, tha se tek objektivat strategjike të paraqitura në planin e KOSTT-it ne qëndrojmë jashtëzakonisht mirë, duke pasur parasysh se strategjia e parasheh diku 1400 megavat energji të ripertritshme për 10 vitet e ardhme, KOSTT i tejkalon këto kapacitete. Mirëmbajtja dhe operimi i sigurt i sistemit tek linjat është 99%, tek stacionet është 95%, implementimi i tregut balancues të energjisë elektrike është funksional, me përjashtim të pjesës veriore, KOSTT ka arritur një stabilitet financiar, duke e rritur nivelin e inkasimit të të hyrave në të gjitha bazat, operimi i zonës së pavarur operuese KOSTT, zonës Shqipëri – Kosovë, KOSTT është duke operuar si zonë e pavarur rregulluese në kuadër të bllokut dhe i përmbush të gjitha obligimet ndaj zonës së Evropës Kontinentale. Anëtarësimi në ENTSO-E dhe mekanizmat tjerë, është një ndër objektivat strategjike, e parasheh që KOSTT-i pas përmbushjes të të gjitha obligimeve ndaj ENTSO-E, të jetë pjesë e ENTSO-E. KOSTT ka një

partneritet të shkëlqyeshëm me palët e interesit, duke përfshirë palët lokale dhe ndërkombëtare, është punëdhënës atraktiv dhe ka siguruar që barazia gjinore të respektohet.

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se në cilësinë e anëtarit të bordit, gjatë vitit 2023 janë marrë një varg vendimesh, të cilat kane ndihmuar institucionin në zbatimin e objektivave të strategjisë. Në aspektin e tregut, integrimi i tregut rajonal është parakusht i cili mundëson burimet e ripërtitshme të plasojnë energjinë e tyre në sistem. Kemi themeluar Bursën Shqiptare të Energjisë, siç është ALPEX, e cila është bursa e parë në vendet e Ballkanit Perëndimor, kemi nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit në mes të Kosovës - Shqipërisë Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, e cila është bashkimi më i madh i energjisë me vendet jo anëtare të BE-së. Gjatë vitit 2023, kemi konkluduar të gjitha aranzhimet me projektin e MCC-së, i cili i mundëson KOSTT-it marrjes e 45 megavat në orë të baterive, me qëllim të rezervës balancuese.

Ajrina Gashi – Hamdiu, anëtare e bordit në KOSTT, tha se lidhur me strategjinë e vitit 2022-2031, mendoj se nga ana e KOSTT-it janë përmbushë shumica prej obligimeve, pavarësisht nga problemet që kemi pasur ndër vite, për shkak edhe të financave në shtyrjen e projekteve të reja.

Nebih Zariqi, anëtar i bordit në KOSTT, tha sa i përket realizimit të strategjisë prej vitit 2022 deri në vitin 2024, mendoj se janë përmbush një pjesë e madhe, por është një pjesë që ka ngel për shkak të shumë rrethanave. E kemi projektin e Ferizajt, i cili është dashur të kryhet, i cili ka vlerë diku 7-8 milion euro dhe tani janë bërë investime 6 milion dhe për shkak të një linjë pret i gjithë projekti 6 milion që është investuar dhe nuk kryhet. Kam kërkuar edhe në bord që të shtyhet ky investim. Edhe në Fushë- Kosovë jemi mbrapa, po ashtu, Malisheva, jemi mbrapa shumë, mirëpo siç dihet Malisheva në sezonin e dimrit ka probleme me furnizim. Investimet që janë paraparë, ne nuk i kemi bërë mjaftueshëm, për vitin 2023 kemi realizim prej 48%, po të mos ishin projekti i Ferizajt dhe Fushë –Kosovës, kishim dal me 2%, janë disa çështje që kanë mundur të shkojnë shumë më mirë.

Arben Dodaj, anëtar i bordit në KOSTT, tha se nuk kemi një vlerësim të saktë, por jemi në harmoni me strategjinë që kemi pasur para vetes, ne si anëtarë të bordit i kemi përkrah të gjitha ato projekte të cilat kane pasur qëllim që të arrijnë një cak apo objektiv të strategjisë.

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se relacionet me bordin janë solide të mira dhe nuk kemi pasur pengesa apo diçka të theksuar, në muajt e fundit ka pasur tendenca për interferime, anëtarët e bordit z. Zariqi dhe znj. Gashi – Hamdiu, janë marrë vazhdimisht me çështje të prokurimit dhe ndoshta më shumë se sa unë shpeshherë, në veçanti në situata të caktuara kanë informata me të shpejta se sa zyrtarët, kanë kërkuar takime me operatorë të ndryshëm dhe ka pasur kërkesa të ndryshëm nga ta, ka raste të tilla individuale. Këtyre tendencave iu kam reaguar edhe me e-maila dhe prej pjesëve kryesore të punëve të mia më është dashur të merrem me këta dy anëtarë të bordit.

Mimoza Kusari – Lila, pyeti, pse nuk e keni njoftuar Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili është aksionar i ndërmarrjes për këto ndërhyrje?

Evetar Zeqiri, Kryeshef Ekzekutiv në KOSTT, tha se kam menduar se këto çështje do të zgjidhen dhe se janë probleme momentale, ta zëmë unë kamë marr vlerësim me notë 2, është absurde dhe tendencë për denigrim. Respektivisht, për çështjen e transformatorit në Fushë-Kosovë, projektet që janë aprovuar në vitin 2018-2020, kanë qenë të ndara, nënstacioni është aprovuar ndaras, transformatori ndaras, linja ndaras, kur janë prokuruar janë prokuruar ndaras, tash një operator ka pasur sukses kurse një tjetër ka pasur mundësi mos mu zgjidh. Tek rasti i Fushë- Kosovës është e njëjta situatë, linja ka qenë e prokuruar me një kompani tjetër, ka probleme pronësore, rasti është në gjykatë dhe nuk mund të ecim tutje, z. Zariqi bën presion të bëhet zgjidhje, por në anën tjetër nëse provon mu taku me operatorin, marrin informata nga zyrtarët, komunikojnë me drejtorët poshtë dhe koordinohen vazhdimisht. Dosjet dhe ofertat e operatorit janë në platformë, as unë nuk kam qasje, ka qasje vetëm zyrtari kompetent dhe komisioni vlerësues i cili caktohet. Informatat që janë publike janë publike, nuk mundet një drejtor të merret në pyetje dhe t'i bëhen pyetje sugjестive.

Ajrina Gashi – Hamdiu, anëtare e bordit në KOSTT, tha se nuk e mohoj që kam kërkuar raporte të cilat edhe janë të incizuara në mbledhjet e bordit, asnjëherë nuk kam kërkuar raport nga zyrtarët pa e përfshirë edhe kryeshefin ekzekutiv. Në fillim të viti 2024, një nga anëtarët e bordit e ka ngrit një çështje ku kemi diskutuar në lidhje me transformatorin, sepse nënstacioni ka përfunduar i tëri, ndërsa pjesa që nuk mund të lëshohet nënstacioni në funksion është pikërisht për shkak të transformatorit. Kryeshefi thotë raporti është proces të prokurimit nga data 29.05.2023, kam kërkuar informacione sepse pagesat nuk mund të ekzekutohen pa u përfunduar transformatori. Ndërkohë kemi kërkuar informatë nëpërmjet kryeshefit dhe përgjigjen e kemi marrë nga Merita Zharku, nëpërmjet kryeshefit ekzekutiv dhe na informon në detaje në lidhje me transformatorin e Fushë- Kosovës. Ajo tha se nëse ne do të dëshironim bllokimin, nuk do ta aprovonim rritjen e buxhetit për projektin në fjalë. Ajo tutje lexoj një e-mail të cilën tha se do ia dërgoj Komisionit me shkrim. Ajo tha në shumicën e rasteve kryeshefi ekzekutiv nuk ka mundur të na jap komente për ngjarjet e caktuara, e kemi rastin për një operator ekonomik, i cili ka bërë lëshim të energjisë në sistemin tonë pa pasur marrëveshje me ne, dhe ne nuk e kemi ditë për 1 vite e gjysmë derisa na ka paditë kompania MatKos, Ne e kemi përkrahur kryeshefin dhe asnjëherë të vetme nuk kam qenë ne zyrën e tij dhe të gjitha diskutimet i kemi të incizuara, nëse kam kërkuar diçka jashtëligjore jam e gatshme të marrë përgjegjësi juridike.

Nebih Zariqi, anëtar i bordit në KOSTT, tha se kryeshefi ka pasur përkrahje maksimale dhe ndoshta kemi gabuar, kohet e fundit filloj të luaj një rol sikur bordi është inekzistent, ka ushtruar presion edhe ndaj stafit, përzierja e tij në kriterin e transformatorit dhe kërkesa ime për informacione ka qenë me qëllim të përfundimit të transformatorit që Fushë- Kosova të mos ketë probleme me furnizim dhe jo ndikim në përzgjedhjen e operatorit, kam kërkuar vetëm pasi është bërë anulimi i parë dhe jo gjatë fazës së prokurimit, dhe kemi kuptuar nga stafi se problemi kryesor ka qenë kriteri që e ka vendosur kryeshefi ekzekutiv, ky nuk ka guxuar që të përzihet në vendosje të kriterëve edhe KRPP, thotë se nuk guxon që kryeshefi të përzihet në kriterë. Tha se pasuria e aseteve të KOSTT-it në vitin 2022 ka qenë 294 milionë 604 mijë euro, ndërsa në vitin 2023 ka rënë për 70 milionë euro, kjo rënie ka ndodh sepse nuk ka pasur investime. Kryeshefi projektet investuese kapitale i ka mbajtur në sirtar dhe nuk i ka shpallë, Kryeshefi ka thënë se vlerat e projekteve 30,000.00 euro dua ti mbaj kaq ditë në tavolinën time, vlerat mbi 100,000.00 apo 200,000.00 euro dua ti mbaj 3 muaj, ky është komunikim zyrtar të cilin do ua përcjellim.

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se pasuritë qarkulluese dhe jo qarkulluese janë zvogëluar për shkak të amortizimit, është kthyer kredia ndaj Ministrisë së Ekonomisë, informatat e përmendura nga Zariqi janë çorientuese.

Jeton Mehmeti – Kryesues i bordit në KOSTT, tha sa i përket marrëveshjes për projektin strategjik, i cili do të realizohet me 100 megavat me solare, pjesë e këtij projekti dhe konsulenti kryesor ka qenë USAID, KOSTT-i është palë nënshkruese e marrëveshjes, pas shpalljes së ankandit prej 100 megavat solare, Ministria e Ekonomisë së bashku me projektin e USAID përmes ESA-s që është fasilitues i drejtpërdrejtë i procesit dhe dokumentacionit, përmes grupit të saj punues ka udhëhequr e periudhës sqaruese, duke ofruar përgjigje në pyetjet e ofertuesve potencial, paralelisht ka përshtatur dokumentet e procesit sipas kërkesave të arsyeshme, për të siguruar realizim të suksesshëm të ankandit. Një prej kërkesave kyçe nga disa ofertues ka qenë kërkesa për sigurimin e pagesës nga KOSTT që potencialisht do të mbulonte vlerën e faturave mujore faturën 9-12 muaj, kërkesa për sigurimin e garancive të pagesa është aprovuar nga grupi punues, ku kanë qenë përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë, ZRRE-se dhe KOSTT-it dhe ky është bërë pjesë e dosjes së tenderit. Kemi edhe një analizë ligjore, të cilën mund ta përcjellim për ju.

Kryetari, tha pse ju apo kryeshefi nuk ia keni dhënë një informate aksionarit për këtë letërgarancinë, cila është baza ligjore që ju e merrni këtë përgjegjësi dhe pa e informuar aksionarin, ose a është dashtë ta pyesni këtë Komision ku sot po raportoni, sepse ne nuk kemi marrë asnjë informatë, e aq më pak konsultim rreth kësaj çështjeje.

Jeton Mehmeti, kryesues i bordit në KOSTT, tha se në këtë proces kemi tri pale të përfshira, është marrëveshja për projektin, kjo marrëveshje e përcakton qartë bazën ligjore, bazën e përgjegjësisë dhe përgjegjësia kryesore i takon Ministrisë së Ekonomisë për të gjithë projektin. KOSTT-i nuk ka dhënë garanci pa marrë aprovimin e grupit punues.

Mimoza Kusari Lila, pyeti, kjo garanci a ka financiarisht implikim dhe a del në pasqyrat tuaja financiare të vitit 2024, si shpenzim i KOSTT-it?

Jeton Mehmeti, kryesues i bordit në KOSTT, tha, jo nuk del në pasqyrat financiare të vitit 2024 si shpenzim i KOSTT-it, në vitin 2026, pas përfundimit të projekti, pas faturës së parë që i dorëzohet KOSTT-it, në rast se KOSTT është në gjendje të vështirë financiare, mund të kërkohet garancia bankare, në rast se ne kemi pasqyrat financiare të rregullta nuk ka nevojë të paguhet garancia bankare. Në mbledhje të bordit kam kërkuar se cili është obligimi ligjor ndaj Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kërkoj që këtë sqarim të cilin e ka dhënë në mbledhje të bordit, t'i jepet fjala znj. Mimoza Byqmeti, sekretare në KOSTT, që ta sqarojë para jush.

Kryetari, tha se kërkoj nga kryeshefi të dijë nëse ndie obligim ligjor që të njoftojë Kuvendin si aksionar para se të merret ky vendim për letërgaranci?

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se KOSTT-i nuk ka lëshuar letërgaranci, KOSTT-i ka nënshkruar marrëveshje për blerje të energjisë.

Nebih Zariqi, anëtar i bordit në KOSTT, tha se bordi ka votuar dhe marrë vendim për letërgarancinë ndaj operatorit privat. Unë personalisht nuk kam votuar sepse kam kërkuar që të merret edhe një mendim nga komisioni i juaj dhe nga ZRRE-ja.

Pal Lekaj, tha se jemi të vetëdijshëm për përgjegjësitë tuaja dhe po ashtu jemi të vetëdijshëm që ju keni një aksionar, që për çdo ndryshim apo kërkesë e vetmja adresë për ju është Kuvendi i Republikës së Kosovës. Asnjë presion në Zyrën e Prokurimit nuk guxon të ndodh të përzihet, as nga kryeshefi, e as nga anëtarët e bordit, janë fusha të ndara. Nëse ju jeni involvuar në përgjegjësi që nuk ju takojnë, askush nuk mund t'ju arsyetojë. Pyeti pse keni angazhuar auditor të jashtëm kur e kemi ZKA-në? Ndërkohë që Raporti i ZKA-së ka një opinion të kualifikuar, janë 5 pika që i ka gjetur auditori, të njëjtat i lexoj. Ai pyeti edhe rreth transformatorit në Fushë-Kosovë, janë 5-6 vite dhe ende nuk është përfunduar, pse këto vonesa, njëjtë janë edhe në Ferizaj dhe Malishevë. Në lidhje me garancinë, ai tha se janë dy garantues, Qeveria e Kosovës dhe aksionari i drejtpërdrejtë, nuk mundet grupi punues me vendos garantues bankar tjetër.

Jeton Mehmeti, kryesues i bordit në KOSTT, tha se pjesa e fundit kur ne është dashtë të marrim leje nga aksionari e kemi sqaruar në aspektin ligjor, unë nuk kam pas mundësi ti drejtohem aksionarit, kur sekretarja e thotë bazën ligjore dhe nivelet e autorizimeve të bordit dhe në çfarë nivele bordi duhet me kërkuar leje nga aksionari. Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës është garantues i kësaj marrëveshjeje, në rast se KOSTT-i dështon, është Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë që jep garancinë shtetërore. Në lidhje me përgjegjësinë e KOSTT-it ne e kemi argumentuar dhe kemi kërkuar garancinë e shtetit dhe në fund të fundit shteti është garantuesi i kësaj marrëveshjeje. Në anën tjetër përgjegjësitë e bordit, përgjegjësitë e kryeshefit dhe përgjegjësitë e Departamentit të Prokurimit janë të ndara dhe janë të rregulluara me ligjet në fuqi. Arsyeja pse ne kemi pas marrëveshje me auditor të jashtëm është sepse ne sikur të mos e kishim atë marrëveshje, do të bënim shkelje ligjore më të madhe se sa që kishim këtë marrëveshje. Linja buxhetore për marrëveshjen me auditorin e jashtëm është aprovuar në bord.

Kryetari, tha pse nuk keni sjellë sot me vete në komision përfaqësuesin e kompanisë që e ka bërë auditimin e jashtëm

Jeton Mehmeti, kryesues i bordit në KOSTT, tha se është ftuar përmes e-mailit, por që gjendet jashtë vendit dhe nuk ka mundur të jetë me ne sot përfaqësuesi i tyre.

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se askush nuk mund të ia ndaloj ZKA-së të ushtrojnë mandatin e tyre, në lidhje me raportin e auditorit të ZKA-së, ky raport është i kualifikuar, baza për kualifikim është mosrivlerësimi i pasurive të KOSTT-it. Nga viti 2006 deri në vitin 2023, asnjëherë auditorët nuk kanë modifikuar opinionin, nuk e kanë ngritë kurrë si çështje, arsyeja pse ne e kemi angazhuar është sepse ZKA-ja ka thënë se nuk bën auditim të veçantë.

Ajrina Gashi – Hamdiu, anëtare e bordit në KOSTT, tha se kur e kemi bërë aprovimin e planit të buxhetit, kemi reaguar disa anëtar të bordit, ne nuk kemi qenë të njoftuar që do të jemi subjekt i auditimit nga ZKA-ja, sepse qartë edhe ZKA-ja e ka potencuar edhe dispozitën e Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Ndërmarrjet Publike, që vetëm në rast se nuk auditohemi nga ZKA-ja kemi të drejtë të marrim shërbime të jashtme të auditimit, për këtë ka qenë i informuar menaxhmenti kurse ne kemi qenë të kufizuar nga këto informata.

Armend Muja, pyeti znj.Gashi-Hamdiu, se a mund ta cekni bazën ligjore që ju referuat?

Ajrina Gashi – Hamdiu, anëtare e bordit në KOSTT, tha se neni 137 i Kushtetutës së Kosovës, Ligji për Ndërmarrjet Publike Neni 33.3, Ligji i Prokurimit Publik dhe Ligji për Auditorin e Përgjithshëm i Zyrës Kombëtare.

Mimoza Kusari - Lila, tha se ju potencuat se edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ndalon auditimin e jashtë, neni 137.3, përcakton kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, citimi i juaj është gabim sepse në asnjë rast nuk ka dispozita ndaluese nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, janë dispozita përshkruese.

Ajrina Gashi – Hamdiu, anëtare e bordit në KOSTT, tha se arsye se pse e hapta këtë rast dhe pse e kam dërguar një e-mail për këtë çështje është sepse këto të gjetura na ngarkojnë të gjithëve si anëtarë të bordit.

Nebih Zariqi, anëtar i bordit në KOSTT, tha se raporti i ZKA-së është dorëzuar në ora 5:25 dhe na është kërkuar të japim komente deri të nesërmen në ora 12, pse kjo nguti dhe afat i shkurtër për të dhënë komente. Ai lexoi pjesë nga procesverbale të mbledhjeve për të cilat tha se do të bashkëngjiten për anëtarët e këtij Komisioni. Tha se kryeshefi ka kërkuar nga zyrtarja e prokurimit të takohen pas orës 16 me operatorin ekonomik në zyrën e tij, aty ka qene zyrtarja e prokurimit, asistentja e tij dhe përfaqësuesi i operatorit ekonomik, kryeshefi në atë takim ka kërkuar nga operatori ekonomik që të tërhiqet nga transformatori në Fushë- Kosovë.

Armend Muja, pyeti si është emri i u.d. të Drejtorit të Prokurimit dhe kush me vendim të kujt është caktuar në atë pozitë?

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha u.d. Drejtor i Prokurimit është z. Besim Gerxhaliu dhe është caktuar me vendimin tim por zyrtar përgjegjës është znj. Merita Zharku sepse punëdhënësi cakton për ushtrimin e detyrave.

Kryetari, kërkoi nga kryesuesi i Bordit dhe të gjithë anëtarëve të bordit që të dërgohen të gjitha materialet dhe komunikimet në ndërhyrjeve përgjatë proceseve të prokurimit, procesverbalet e mbledhjeve dhe çdo material që ju e shihni të arsyeshme.

Armend Muja, tha se në lidhje me deklarinimin e znj. Gashi-Hamdiu, sa i përket plotësim ndryshimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, thotë se auditimin për të hyrat financiare do ta bëjë ZKA-ja, në të kundërtën zyrtari i prokurimit të ndërmarrjes publike do ta prokurojë shërbimin e një auditori të jashtëm.

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se jemi pajtuar vetëm me 2 gjetje, të gjeturat tjera nuk i kemi pranuar, kjo nuk do të thotë se ne nuk do të marrim masa mbi gjetjet në bazë të këtij raporti, jemi në proces të përgatitjes së planit të veprimit. Për çështjen e vlerësimit, ne do të kërkojmë buxhetin në Komitet të auditimit fillimisht, komiteti i rekomandon bordit, bordi e aprovon dhe pastaj e dërgojmë në ZRRE dhe nëse ata e aprovojnë shumën e nevojshme, ne e fusim në buxhet dhe vitin tjetër e bëjmë vlerësimin. Kontrata e kositjes së barit ka

përfunduar në OSHP, vlerat e nënstacioneve janë të larta dhe nuk mund të lejojmë rrezikimin për tu djegë nënstacionet për kontrata me vlera rreth 1000 euro. Lidhur me mirëmbajtjen e automjeteve, janë automjete me pajisje speciale, është në pyetje siguria e punëtorëve dhe kontrata ka qenë në OSHP, derisa të shpallet vendimi i OSHP-së është dashtë të vendosim për mirëmbajtje të automjeteve, njëjtë ka ndodh edhe me kontratën për furnizim për material për zyra.

Armend Muja, pyeti, a është e vërtete se një operator, tek mirëmbajtja e automjeteve ka ofertuar me dy kompani të tija dhe ai e ka dërguar vetën në OSHP dhe kur e ke marrë vesh këtë informacion?

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha po është e vërtetë që një operator ka aplikuar më kompani të tija private në rastin e mirëmbajtjes së automjeteve.

Kryetari, tha se nga një koleg u potencua se kryeshefi, dosjet e prokurimit i mban në zyrë, a ke eventualisht ndonjë dosje të prokurimit në zyrë, a ke kërkuar me herët, a ke kërkuar vendosje të kritereve në termat e referencës?

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se prej që është fut platforma e prokurimit s'ka dosje fizike dhe s'kam pas asnjëherë dosje të operatorëve.

Kryetari, pyeti, a keni nis ndonjë shkresë në lidhje me jo balancat gjatë vitit 2023 apo 2024 me Ujmanin ndaj ZRRE-së?

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se deri në fund të vitit 2023 njoftimet janë bërë me e-mail, unë nuk kam dhe nuk e di për çka. Operatori i tregut dërgon njoftimet kur palët janë në jo balanca të vazhdueshme, ka ndodh që edhe unë kam dërguar.

Armend Muja, kërkoj të dërgohen këto njoftime edhe për anëtarët e Komisionit.

Kryetari, pyeti në lidhje me 3 e-mail që kanë ardhur nga 3 zyrtarë të KOSTT-it të cilët janë ankuar në vendimet e juaja dhe shkelje të paligjshme të cilat janë të evidentuara, këto janë dërguara në e-mail zyrtare të deputetëve.

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se ankesat të cilat janë bërë në institucionin tonë i kam por shkresat që iu janë dërguar juve, nuk i kam dhe kërkoj që këto shkresa t'ia përcjellin. Në lidhje me ankesat e zyrtareve, ai tha se është çështje e punëdhënësit se në çfarë detyra angazhon zyrtarët.

Kryetari, tha se për të gjitha këto shqetësime të ngritura nga zyrtarët tuaj do të dërgojmë shkresa, ai kërkoj që për këto 3 raste veç e veç të na njoftoni në detaje dhe të na njoftoni për qëndrimet tuaja. Ai pyeti a ekziston ndërhyrja e juaj në prokurim?

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, tha se asnjëherë nuk kam interferuar në prokurim, ndërsa përgjegjësit e mia ligjore kam mandat të plotë që ti ushtroj.

Nebih Zariqi – anëtar i bordit në KOSTT, tha nëse doni ta shpëtoni KOSTT-in, duhet të ndërmerri masa, kryeshefi ka vepruar pa pëlqim të bordit dhe pa profesionalizëm. Drejtori i IT-së të dërgohet në burime njerëzore, kjo nuk ka asnjë logjikë, vendimi ndaj zyrtares së prokurimit është një hakmarrje nga ana e kryeshefit.

Jeton Mehmeti, kryesues i bordit në KOSTT, tha se nga ZKA-ja vitin e kaluar kemi pasur rekomandim që bordi duhet të bëjë ndarjen e nivelit të përgjegjësisë në makro dhe mikro, deri në vitin 2022 nuk e kemi pasur këtë ndarje. Bordi i drejtoresve nuk mundet të kërkojë nga kryeshefi të caktojë ekipin e tij dhe në të njëjtën kohë të kërkojë përgjegjësi.

Armend Muja, kërkoj që me shkrim të dërgohen të gjitha marrëveshjet e shitblerjes për energji dhe çmimin referent. Tek konkurrentët në ankandin e energjisë është edhe “Notus Energji Kosova”, ai tha se nga sinjalizues është njoftuar se janë 3 punëtorë të KOSTT të cilët kanë qenë të angazhuar në këtë kompani dhe a paraqet konflikt interesi kjo? Në lidhje me pronat e KOSTT-it ai pyeti në lidhje me 700 m² në qendër të Prishtinës, a i kanë kaluar KOSTT-it sepse në vitin 2022 jeni zotuar se do ta ktheni këtë pronë? Po ashtu, në lidhje me marrëveshjet për shitblerjen e energjisë për import dhe eksport për vitin 2023? Kërkoj për të gjitha të dërgohen me shkrim, si dhe për të gjitha projektet kapitale të vitit 2023, si dhe ku është statusi i tyre, po ashtu, dhe kontratat për shërbime për vitin 2023, cila ka qenë procedura dhe metoda e e përzgjedhjes së tyre? Ai tha sa i përket skemës së mbështetjes, në bazë të ZRRE-së, juve ju lejohen 22 milionë euro për fondin e BRE-ve, në bazë të raportit që ju keni dërguar, keni shpenzuar 46 milionë euro, me duhet një shpjegim pse duhet një shpenzim kaq i madh, pse duhet të jetë kosto kaq e lartë e këtij fondi. Kërkoj që të dërgohet përgjigje me shkrim edhe mënyra se si është vendosur u.d. i Drejtorit të Prokurimit.

Evetar Zeqiri, kryeshef ekzekutiv në KOSTT, kërkoj që t’i dërgohen e-maillet që kanë dërguar zyrtarët e KOSTT-it te deputetët.

Kryetari, tha se Komisioni nuk iu raporton juve, por ju Komisionit dhe presim që përgjigjet më shkrim t’i dërgoni në një afat sa më të shpejtë.

Jeton Mehmeti, kryesues i bordit në KOSTT, tha se në një afat shumë të shpejtë do të dërgohen të gjitha materialet e kërkuara.

Komisioni konkludoi së pasi të dërgohen përgjigjet më shkrim nga ana e KOSTT-it, Komisioni të vazhdojë raportimin e bordit në një mbledhje tjetër.

3. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 16:15.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Ferat Shala,

Kryetar i Komisionit